

Vendim nr. 122 datë 03.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Marjana Semini, Anëtare

Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 03.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (L) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: LAURANT ÇAKOLLARI, përfaqësuar nga avokatët Ilir Golemi dhe Ylli Kameri.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 74, datë 26.03.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2023-779, datë 11.05.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 4 të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 846, datë 28.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesi është deklaruar fajtor për veprat penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim

dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 78 e 25, dhe 278, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (KP) dhe, në bashkim të dënimeve, është dënuar përfundimisht me 15 vjet burgim. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur ankim, vendimi i dënimit është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1153, datë 14.11.2012 dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2014-1075 (143), datë 05.06.2014.

2. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të mësipërme. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 33, datë 27.02.2015, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se pretendimet e kërkuesit ishin haptazi të pabazuara.

3. Në datën 04.12.2017 kërkuesi ka paraqitur kërkesë në gjykatën e shkallës së parë, me objekt lirimim me kusht, duke pretenduar se kishte vuajtur mbi 3/4-ën e dënimit të caktuar. Kërkesa është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë me vendimin nr. 112, datë 21.12.2017, ndaj pjesa e mbetur e dënimit prej 2 vjetësh, 8 muaj e 7 ditësh është pezulluar dhe kërkuesi është liruar. Kundër vendimit ka paraqitur apel prokurori, si dhe apel kundërshtues kërkuesi.

4. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 74, datë 26.03.2018 (gabimet materiale të të cilit janë ndrequr me vendimin nr. 68, datë 07.05.2018), ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesës për lirimim me kusht të kërkuesit, me arsyetimin se nuk ishin plotësuar kriteret kumulative të parashikuara nga neni 64 i KP-së për lirimim përpara kohe me kusht.

5. Rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk është pranuar për shqyrtim nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2023-779, datë 11.05.2023, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

6. Në datën 12.03.2024 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 08.04.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara i janë cenuar:

7.1. *Liria personale*, e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, pasi kërkuesi është liruar prej 6 vjetësh në zbatim të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dënimi penal e ka humbur qëllimin e tij. Vendimet e kundërshtuara janë të paqarta dhe në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 2, datë 25.05.2015 të Gjykatës së Lartë, duke cenuar edhe parimin e shtetit të së drejtës.

7.2. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

7.2.1. *E drejta për një gjykatë të caktuar me ligj*, pasi në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve Gjykata e Lartë ka marrë funksione ekzekutive, duke llogaritur vetë masën e mbetur të dënimit. Në këtë mënyrë është cenuar edhe parimi i decentralizimit të pushteteve, në themel të të cilit qëndron parimi i subsidiaritetit, pasi jeta, liritë, të drejtat dhe dinjiteti i kërkuesit janë centralizuar dhe janë lënë në diskrecion të gjykatës. Edhe prokuroria nga ana e saj, në cenim të parimit të devolucionit, e ka lënë gjykatën e apelit të gabojë.

7.2.2. *E drejta për një gjykatë të paanshme*, pasi gjyqtarët që shqyrtuan çështjen e kërkuesit ishin në proces rivlerësimi dhe më pas janë larguar nga sistemi i drejtësisë, ndaj nuk ishin të vëmendshëm ndaj çështjes së tij. Për pasojë, janë cenuar edhe parimet e interesit të përgjithshëm, të drejtësisë efektive dhe të baraslargësisë.

7.2.3. *E drejta për gjykim të drejtë*, pasi procesi nuk ka qenë i drejtë, transparent dhe profesional. Kërkuesit i janë hequr garancitë procedurale lidhur me kohëzgjatjen e procesit dhe njoftimin. Gjykatat e zakonshme kanë pasur për qëllim rikthimin në burg të tij, ndaj nuk duhej të legjitimonin mbrojtësin, po duhej të kishin thirrur personalisht kërkuesin.

7.2.4. *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, pasi trajtimi i çështjes së kërkuesit me standard të ndryshëm ka përcjellë tek ai ndjenjën e pabarazisë dhe e ka vendosur në pozitë të papranueshme. Kërkuesi është diskriminuar pasi edhe pse ka kryer të gjitha përpjekjet, me ndihmën e organizatave jofitimprurëse për këtë qëllim, për të normalizuar marrëdhëniet me familjarët e viktimës, përpjekjet nuk janë vlerësuar drejt nga gjykatat.

7.2.5. *E drejta për mbrojtje efektive*, pasi avokati i parë nuk e ka njoftuar kërkuesin për vendimin e Gjykatës së Lartë.

7.2.6. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet e kundërshtuara janë të pasakta dhe të paqarta, si dhe të pambështetura në prova.

7.2.7. *Parimi i sigurisë juridike, të drejtave të fituara dhe pritshmërive të ligjshme*, garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi kërkuesi iu është drejtuar gjykatave me pritshmërinë se do të zbatohet vendimi unifikues nr. 2/2015. Ai fitoi lirinë personale, e cila iu hoq me anë të ndreqjes së gabimeve materiale të vendimit nga gjykata e apelit. Vendimet e kundërshtuara vendosën rikthimin në burg të kërkuesit, ndonëse ishte urdhëruar më parë lirimi i tij, ndaj ai është vënë në paqartësi ligjore, faktike, sociale, ekonomike e kulturore. Kërkuesi nuk ka

mundur të regjistrojë në regjistrin e gjendjes civile fëmijët e tij të lindur jashtë shtetit, ndaj janë cenuar edhe të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

7.2.8. *Parimi i ligjshmërisë*, pasi gjykatat në vendimet e kundërshtuara nuk kanë treguar dispozitat ligjore që ka shkëlur kërkuesi. Gjykatat nuk kanë thirrur IEVP-në, Tropojë dhe Shërbimin e Provës në gjykim, dhe as nuk kanë revokuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë për pezullimin e dënimit me burgim.

7.2.9. *Parimi i respektimit të të drejtave themelore*, i parashikuar në nenin 15 Kushtetutës, pasi kërkuesi është vënë në situatë të paqartë dhe të pasaktë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkëlur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës. Ai është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Një kriter tjetër paraprak është *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës. Kolegji konstaton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në

dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin e datës 11.05.2023 të Gjykatës së Lartë dhe sipas informacionit të kësaj të fundit ai është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 22.09.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 12.03.2024, pra pas 5 muajve e 18 ditëve. Kërkuesi ka pretenduar se ka marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 05.01.2024, kur një prej avokatëve të tij i është vënë në dispozicion dosja gjyqësore nga gjykata e shkallës së parë. Gjithashtu, kërkuesi ka parashtruar se avokati tjetër i tij, që kishte nënshkruar edhe rekursin, është larguar jashtë shtetit për shkak të problemeve shëndetësore dhe familjare.

13. Duke analizuar të dhënat e mësipërme në raport me standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, Kolegji çmon se afati ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues në rastin e kërkuesit ka filluar në datën 22.09.2023, kur vendimi i Gjykatës së Lartë është publikuar në faqen zyrtare dhe është bërë i disponueshëm për palët. Në nxjerrjen e këtij konkluzioni, Kolegji mban në konsideratë se procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë është vënë në lëvizje nga vetë kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur, ndaj ai kishte interesin dhe mundësitë për të ndjekur fatin e ankimit të tij. Po kështu, Kolegji vë në dukje se për paraqitjen e ankimit kushtetues individual kërkuesi rezulton të ketë zgjedhur dy mbrojtës, një prej të cilëve është mbrojtësi që e ka përfaqësuar atë edhe në procesin në Gjykatën e Lartë. Në këtë situatë, është i papranueshëm argumenti i tij se njëri prej mbrojtësve është larguar jashtë shtetit dhe se mbrojtësi tjetër ka pasur mundësi të njihej me aktet vetëm nga gjykata e shkallës së parë.

14. Për sa më lart, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ndaj kërkesa është e papranueshme *ratione temporis*.

15. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.